



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE

KALENDARI I SISTEMIT TË PLANIFIKIMIT TË INTEGRUAR  
PËR VITIN 2009

Përgatitur nga: Departamenti i Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndhmës së Huaj,  
Ministria e Financave dhe Ministria e Integritimit Europian

Janar 2009

TABELA E LËNDËS

STRATEGJIA KOMBËTARE PËR ZHVILLIM DHE INTEGRIM [SKZHI] .....	2
INTEGRIMI EVROPIAN.....	5
PROGRAMI BUXHETOR AFATMESEM [PBA].....	11
NDIHMJA E HUAJ.....	15

AKRONIMET E PËRDORURA NË TEKST

DEBASKON	Departamenti i Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj
DShIP	Dokumenti Shumëvjeçar Indikativ i Planifikimit
GSBI	Grupi i Punës për Strategji, Buxhet dhe Integrim
IPA	Instrumenti i Para-Aderimit
KM	Këshilli i Ministrave
KPS	Komiteti i Planifikimit Strategjik
MF	Ministria e Financave
MIE	Ministria e Integritit European
MIP	Menaxhimi i Investimeve Publike
MSA	Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit
NjQFK	Njësia Qendrore e Financimit dhe Kontraktimit
PBA	Programi Buxhetor Afatmesëm
PIM	Plani i Integruar i Ministrisë
PMM	Plani i Monitorimit të Ministrisë
PShIP	Planifikimi i Shpenzimeve dhe Investimeve të Programit
RPP	Rishikimi i Politikës së Programit
SPI	Sistemi i Planifikimit të Integruar
SI	Sistem Informacioni

*Kalendari i Sistemit të Planifikimit të Integruar* për vitin 2009 menaxhohet nga koordinatorët e caktuar për këtë, Migena Dako ([mdako@km.gov.al](mailto:mdako@km.gov.al)) në Departamentin e Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndhmës së Huaj, Kesjana Halili ([khalili@minfin.gov.al](mailto:khalili@minfin.gov.al)) në Ministrinë e Financave dhe Patris Kraja ([patris.kraja@mie.gov.al](mailto:patris.kraja@mie.gov.al)) në Ministrinë e Integritit Europian. Në ministritë e linjës koordinatorët për kalendarin e SPI-së janë Sekretarët e Përgjithshëm.

## STRATEGJIA KOMBËTARE PËR ZHVILLIM DHE INTEGRIM [SKZHI]

### Proceset dhe produktet kryesore

1. Plani i Integruar i Ministrisë 2009
  - a. Raporti Vjetor mbi Rezultatet (2008)
  - b. Plani i Monitorimit të Ministrisë (2009)
2. Politikat Prioritare
  - a. Përcaktimi i politikave dhe projekteve prioritare për PBA 2010-2012
3. Procesi i hartimit të PBA-së 2010-2012
  - a. Vlerësimi i prioriteteve: Rishikimi i Politikës së Programit (RPP)
  - b. Vlerësimi i prioriteteve: Planifikimi i Shpenzimeve dhe Investimeve të Programit (PSHIP)
  - c. Vlerësimi i prioriteteve: Buxheti vjetor
4. Raporti Vjetor i Progresit për vitin 2008
5. Monitorimi i strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale
6. Rishikimi i OZHM-ve

### Vështrim i përgjithshëm

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) u miratua në mars të vitit 2008, dhe në të përmbledh 21 strategji sektoriale dhe 16 strategji ndërsektoriale. Gjatë vitit 2009 dhe viteve në vazhdim, vëmendja do të përqendrohet në zbatimin, monitorimin dhe raportimin e SKZHI-së, si procesi kryesor i planifikimit të politikave dhe planifikimit financiar.

#### 1. *Plani i Integruar i Ministrisë 2009*

Plani i Integruar i Ministrisë (PIM) përmbledh angazhimet kryesore në kuadrin e PBA-së, përfshin të gjitha angazhimet në kuadrin e integritit evropian, legjislativonin e planifikuar, investimet publike madhore, masat e korrupsionit dhe projektet më të rëndësishme të ndihmës së huaj. Plani i Integruar i Ministrisë botohet në katërmujorin e parë të vitit 2009 dhe përmbledh si pjesë të rëndësishme të tij:

- a. *Raportin Vjetor të Rezultateve për vitin 2008*, i cili shpreh rezultatet e arritura mbi angazhimet e shprehura në Planet e Integuara të Ministrive të vitit paraardhës.
- b. *Planin e Monitorimit të Ministrisë për vitin 2009*, i cili shërben për monitorimin dhe raportimin dhe përbëhet nga një grup objektivash dhe detyrimesh ligjore të rëndësishme. Këto objektiva dhe detyrime ligjore, përcaktohen në bashkëpunim me ministritë e linjës në muajin shkurt. Monitorimi i tyre do të bëhet çdo vit.

#### 2. *Politikat prioritare*

Që në fillim të vitit 2009 do të fillojë procesi i planifikimit në kuadër të Procesit Buxhetor Afatmesëm PBA 2010-2012. DEBASKON luan një rol shumë të rëndësishëm, duke siguruar që prioritetet e politikave të shprehura në strategjitë sektoriale dhe ndërsektoriale, të reflektohen në përcaktimin e tavaneve buxhetore gjatë procesit të PBA-së. Përpara fillimit të mirëfilltë të procesit të PBA-së,

Ministria e Financave dhe DEBASKON përgatisin tre materiale për Komitetin e Planifikimit Strategjik: 1) kuadrin makroekonomik (MF); 2) Dokumentin e Politikave Prioritare 2010-2012 (DEBASKON); 3) Programin Financiar Publik Afatmesëm (MF); 4) kalendarin e SPI-së (MF, MIE, DEBASKON); 5) propozimet për tavanet buxhetore fillestare (MF).

*a. Dokumenti i Politikave Prioritare, për t'u përfshirë në PBA 2010- 2012*

DEBASKON do të hartojë *Dokumentin e Politikave Prioritare* me qëllim që të ndihmojë Komitetin e Planifikimit Strategjik (KPS) në përcaktimin e taveve buxhetore të ministrive dhe dhënien e informacionit për projekte të mundshme dhe për nevoja financiare për PBA 2010-2012. Ky dokument do të bazohet në propozimet e ardhura nga ministrinë dhe do të analizohet edhe nga DEBASKON. Për të ndihmuar ministrinë e linjës do të shpërndahen udhëzime të përgatitura nga DEBASKON, në janar 2009, mbi të cilat ministrinë do të identifikojnë politika të reja apo ekzistuese, që kanë një vlerë të konsiderueshme financiare. Propozimet e ministrive do të paraqiten për diskutim dhe miratim në KPS në muajin shkurt. Aty do të vendoset për prioritetet që do të merren parasysh në përcaktimin e taveve të PBA 2010-2012, të cilët do të miratohen më pas në mbledhjen e KPS-së në muajin shkurt.

*3. Procesi i hartimit të PBA-së*

*a. Vlerësimi i prioriteteve: Rishikimi i Politikës së Programit (RPP)*

Në kuadrin e procesit të PBA-së, çdo ministri përgatit deklaratat për politikën e programeve të saj buxhetore, të cilat shqyrtohen dhe rishikohen brenda ministrisë. Ky rishikim kryhet gjatë muajit mars, pas caktimit të taveve për çdo ministri linje, në kuadër të përgatitjes së PBA-së 2010-2012. Rishikimi i politikave të programeve përcakton shpenzimet e detajuara për secilin program si dhe projektet e investimeve, dhe bën të mundur që ministrinë të hartojnë buxhetet indikative të programeve. DEBASKON në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Integritimit do të bashkërendojë procesin e RPP-së. Qëllimi i RPP-ve është që synimet dhe objektivat e shprehura në SKZHI, në strategjitë sektoriale dhe ndërsektoriale, si dhe në MSA të reflektohen sa më mirë në kërkesat për shpenzime të ministrive të shprehura në PBA.

*b. Vlerësimi i prioriteteve: Planifikimi i Shpenzimeve dhe Investimeve të Programit (PSHIP)*

Gjatë periudhës maj - qershor, ministrinë e linjës paraqesin në Ministrinë e Financave, në kuadrin e PBA-së, Planifikimin e Shpenzimeve dhe Investimeve të Programit (PSHIP). Këto parashikime rishikohen më pas nga Ministria e Financave, DEBASKON dhe Ministria e Integritimit Europian, dhe prezantohen për diskutim në negociatat që zhvillohen me ministrinë e linjës. DEBASKON dhe Ministria e Integritimit do të jenë pjesë e këtyre negociatave dhe do të fokusohen në realizimin e objektivave të strategjive sektoriale dhe angazhimeve të MSA-së, nëpërmjet procesit të PSHIP-it. Mbi bazën e këtyre negociatave të zhvilluara, Ministria e Financave përgatit një draft të PBA-së 2010-2012, të cilin e paraqet për diskutim dhe miratim në KPS.

*c. Vlerësimi i prioriteteve: buxheti vjetor 2009*

Nëse ka ndryshime të konsiderueshme, DEBASKON do të bëjë një vlerësim për të matur impaktin e këtyre ndryshimeve në zbatimin e strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale.

*4. Raporti Vjetor për Progresin e SKZHI-së 2008*

Raporti Vjetor i Progresit të SKZHI-së paraqet ecurinë e arritur kundrejt rreth 45 indikatorësh të nivelit të lartë. Një pjesë e mirë e këtij informacioni grumbullohet nëpërmjet INSTAT-it ose vëzhgimeve të veçanta dhe kërkon vetëm një kontribut nga ana e ministrive. Ky raport përgatitet dhe përfundon në fillim të gjashtëmujorit të parë të vitit 2009.

*5. Rishikimi i OZHM-ve*

Në kuadër të përgatitjes e miratimit të SKZHI-së, Shqipëria ka harmonizuar OZHM-të me axhendën e Bashkimit Europian dhe strategji të tjera sektoriale e ndërsektoriale.

Raportimi dhe monitorimi i progresit të OZHM-ve është një proces i rëndësishëm që ndihmon në rinovimin e angazhimeve politike mbi bazën e objektivave të zhvillimit. Ky proces kontribuon në

çështje që lidhen me prioritete specifike të OZHM-ve në strategjitë kombëtare, sektoriale e ndërsektoriale.

DEBASKON në bashkëpunim me PNUD dhe Ministrinë e Linjës do të fillojë procesin e rishikimit të OZHM-ve për Shqipërinë në mënyrë që ato të jenë ambicioze dhe realiste. Ky proces do të përfundojë në katërmujorin e parë të vitit 2009.

## KALENDARI PËR SKZHI-në PËR VITIN 2009

### 1. Plani i Integruar i Ministrisë (PIM)

Muaji	Data	Institucioni përgjegjës	Veprimi
Shkurt	9	DEBASKON	Përgatit stukturën e PIM-eve 2009 si dhe udhëzimet për të raportuar mbi PIM-et 2008 dhe i dërgon te Ministrinë e Linjës
	20	DEBASKON ML	Negociohen indikatorët që do raportohen në Planet e Monitorimit të Ministrive 2009
Mars -Prill	13	ML	Ministrinë sjellin PIM-et 2009 të plotësuara dhe Raportin Vjetor të Rezultateve mbi PIM-et 2008
	27	DEBASKON	Finalizon PIM-et 2009
Maj		DEBASKON	Publikohen PIM-et 2009 si dhe Raporti Vjetor i Rezultateve 2008

### 2. Politikat Prioritare

Muaji	Data	Institucioni përgjegjës	Veprimi
Janar		DEBASKON ML	Ministrinë dërgojnë zyrtarisht politikat e tyre prioritare për PBA 2010-2012
Shkurt		KPS	KPS miraton politikat prioritare më të rëndësishme për t'u përfshirë në tavanet buxhetore të PBA 2010-2012

### 3. Raporti Vjetor për Progresin e SKZHI-së

Muaji	Data	Veprimi
Shkurt	16	Shpërndahen udhëzimet për kontributin e ministrive në Raportin për Progresin për vitin 2008
Mars	9	Dërgohet kontributi nga institucionet e përzgjedhura
Maj	29	Finalizohet Raporti vjetor i Progresit
Qershor		Botohet raporti

### 4. Rishikimi i OZHM-ve

Muaji	Data	Veprimi
Janar	6	Kontaktimi i ML-ve për krijimin e grupeve të punës për rishikimin e OZHM-ve
Shkurt	20	Organizimi i mbledhjeve të grupeve të punës
Mars	30	Finalizimi i procesit të rishikimit dhe paraqitja e rezultateve

## INTEGRIMI EVROPIAN

### Proceset dhe produktet kryesore

1. Zbatimi i MSA-së:
  - a. Vlerësimi i zbatimit të Planit Kombëtar për zbatimin e MSA-së
  - b. Reflektimi i prioriteteve të Planit të zbatimit të MSA-së në procesin buxhetor dhe të PBA-së
  - c. Monitorimi i Planit Kombëtar për zbatimin e MSA-së
  - d. Analiza e Dokumentit të Partneritetit Evropian dhe Raportit Vjetor për progresin
  - e. Ngritja e strukturave të përbashkëta BE - Shqipëri, me hyrjen në fuqi të MSA-së
  
2. Instrumenti i Para-aderimit (IPA)
  - a. Rishikimi i Dokumentit Indikativ të Planifikimit Shumë-Vjeçar
  - b. Finalizimi i programimit IPA 2009
  - c. Programimi i IPA 2010
  - d. Decentralizimi
  
3. Fillimi i procesit të përkthimit të "acquis" në gjuhën shqipe
  - a. Çertifikimi i akteve të përkthyera
  - b. Përkthimi i akteve duke reflektuar prioritetet e Planit Kombëtar për zbatimin e MSA-së
  - c. Standartizimi i përkthimit

### Vështrim i përgjithshëm

Qeveria shqiptare do të vazhdojë të mbetet e angazhuar plotësisht në zbatimin e axhendës së saj Evropiane, si një prioritet i politikës së jashtme, veçanërisht gjatë vitit 2009. Pas përmbushjes së procesit të ratifikimit të MSA-së nga të gjithë vendet anëtare, në fillim të vitit 2009 planifikohet që në muajin janar, të realizohet dorëzimi i aplikimit për anëtarësim në Bashkimin Evropian, nga autoritetet shqiptare si dhe ndjekja e të gjithë procedurave të lidhura me të.

Datat e përcaktuara në kalendarët më poshtë në disa raste janë vetëm indikative. Ato do të saktësohen rast pas rasti, në varësi të kalendarit të shërbimeve të KE-së për çështjet përkatëse.

Gjatë vitit 2009, në Ministrinë e Integrimit u ngrit dhe po funksionon Drejtoria e Përkthimit të Legjislacionit Evropian. Prioritetet e përkthimit do të vendosen nga Ministria e Integrimit në bashkëpunim me ministritë e interesuara.

#### 1. Zbatimi i MSA-së

##### *a. Vlerësimi i zbatimit të "Planit Kombëtar për zbatimin e MSA-së"*

Ministria e Integrimit Evropian do të drejtojë procesin e rishikimit të Planit Kombëtar për zbatimin e MSA-së, bazuar në raportin e progresit të KE-së të Nëntorit 2009. Këtë vit parashikohet gjithashtu edhe një rivlerësim i plotë i planit nga pikëpamja e formës dhe përmbajtjes, për të siguruar një lexueshmëri më të lartë dhe për të pasqyruar metodat e reja të raportimit elektronik. Gjithashtu, gjatë këtij rishikimi një vëmendje e veçantë do t'u kushtohet aspekteve që lidhen me hyrjen në fuqi të MSA-së.

##### *b. Reflektimi i prioriteteve të Planit Kombëtar për zbatimin e MSA-së në PBA*

Gjatë ciklit të planifikimit buxhetor, ministritë e linjës duhet t'i kushtojnë një rëndësi të veçantë sigurimit të një lidhjeje organike midis prioriteteve të Planit Kombëtar për Zbatimin e MSA-së dhe procesit buxhetor afatmesëm. Për këtë arsye, kalendarit të rishikimit të planit do të rakordohet me atë të përgatitjes së PBA-së.

*c. Monitorimi i Planit Kombëtar për Zbatimin e MSA-së*

Plani Kombëtar për Zbatimin e MSA-së do të vazhdojë të monitorohet rregullisht çdo muaj gjatë vitit 2009, si nëpërmjet sistemit "on line" ashtu dhe raportimeve periodike. Komisionit Evropian do t'i dorëzohen raporte dy-mujore si dhe kontributet për Progres Raportin vjetor, i pari në mes të muajit qershor 2009 dhe kontributi i dytë në fillim të muajit tetor 2009. Disa të dhëna të raportimit mund të ndryshohen për t'iu përshtatur ritmit të kërkesave që vijnë nga Komisioni Evropian.

*d. Analiza e Dokumentit të Partneritetit Evropian dhe Raporti Vjetor i Progresit*

Në nëntor 2009, Komisioni Evropian prezantoi Raportin Vjetor të Progresit gjatë procesit të Stabilizim-Asociimit. Qeveria do të vendosë për rishikimin e Planit Kombëtar për Zbatimin e MSA-së duke marrë parasysh rekomandimet dhe përparësitë e përcaktuara në Raportin Vjetor. Nuk është marrë ende një vendim në lidhje me këtë dhe kalendari përkatës nuk është përcaktuar.

*e. Ngritja e strukturave të përbashkëta BE-Shqipëri, me hyrjen në fuqi të MSA-së*

Me hyrjen në fuqi të MSA-së do të ngrihen strukturat e përbashkëta BE-Shqipëri, që mbikëqyrin zbatimin dhe realizimin e Marrëveshjes kjo e përcaktuar në nenet 116, 120 dhe 121 të MSA-së. Do të ngrihet Këshilli i Stabilizim-Asociimit dhe Komiteti i Stabilizim-Asociimit. Po në këtë kuadër do të ngrihen dhe Nënkomitetet KE-Shqipëri.

*2. Instrumenti i Para-aderimit (IPA)*

Programi CARDS mbetet në fazën e zbatimit të projekteve dhe nuk kërkon më ndonjë veprimtari programuese. Planifikimi dhe programimi në lidhje me asistencën e BE-së tani bëhet vetëm për Instrumentin e Para-zgjerimit (IPA).

*a. Dokumenti Indikativ i Planifikimit Shumë-vjeçar për periudhën 2009-2010*

Gjatë vitit 2007 hyri në fuqi marrëveshja e re kuadër për zbatimin e Instrumentit të Para-Aderimit IPA, e cila parashikon rregullat e përgjithshme për shtetet përfituese për zbatimin e asistencës komunitare. Gjatë vitit 2009, Ministria e Integritimit në bashkëpunim me Ministrinë e Linjës dhe Komisionin Evropian rishikoi dokumentin ekzistues të planifikimit shumë-vjeçar (MIPD) 2007-2009, në bazë të prioriteteve të Partneritetit të ri 2007.

*b. Finalizimi i programit IPA 2008*

Pas diskutimit dhe miratimit nga Komiteti IPA i Komisionit Evropian të Programit IPA 2008 gjatë tremujorit të parë 2009, pritet nënshkrimi i marrëveshjes financiare, e cila do t'i hapë rrugë implementimit të projekteve të përfshira në këtë program.

*c. Programimi i IPA-s për vitin 2009 dhe fillimi i programit të IPA 2010*

Procesi i planifikimit për IPA 2009 ka filluar në muajin korrik 2009 dhe mendohet që brenda muajit janar 2009 të jetë gati paketa e projekt fishave për IPA 2009, të cilat do t'i përcillen Shërbimeve të Delegacionit të KE-së në Tiranë, për komente dhe sugjerime. Të gjitha komentet/sugjerimet e tyre do të reflektohen nga institucionet përfituese. Më tej, paketa finale do t'i përcillet për miratim Shërbimeve të KE-së në Bruksel sipas procedurave përkatëse. Në muajin korrik 2009 fillon programimi i IPA 2010.

*d. Decentralizimi*

Në vijim të punës së filluar gjatë vitit 2007, dhe në vazhdim gjatë vitit 2009, janë marrë një sërë hapash të rëndësishëm drejt decentralizimit të asistencës komunitare, përfshirë caktimin e zyrtarëve të programimit sektorial (SPO) në çdo ministri dhe ngritjen e Njësisë Qendrore të Financimit dhe Kontraktimit (NJQFK) pranë Ministrisë së Financave. Parashikohet që akreditimi i strukturës së Njësisë Qendrore të Financimit dhe Kontraktimit (NJQFK) bazuar në plotësimin e kërkesave të

Komisionit Evropian mbi “Conferral of Management” (Akreditimin në BE) të Shqipërisë, të kryhet gjatë vitit 2011.

Kalendari i mëposhtëm është parashikim dhe Ministria e Financave do të jetë në kontakt me Delegacionin Evropian në kuadër të procesit kompleks të plotësimit të kërkesave për një menaxhim të decentralizuar të asistencës komunitare dhe akreditimin e NjQFK-së, që do të jetë përgjegjëse për prokurimin, pagesat tek kontraktorët dhe disbursimin e fondeve, monitorimin e kontratave, auditimin, etj.

### 3. Përkthimi i “*acquis communautaire*” në gjuhën shqipe

Një komponent i rëndësishëm i procesit të Stabilizim-Asociimit drejt anëtarësimit të plotë është përkthimi i legjislacionit evropian - “*acquis communautaire*” në gjuhën shqipe. Për këtë qëllim, në zbatim të VKM nr.119/2007 për “Procedurat e përkthimit të legjislacionit të Bashkimit Evropian në gjuhën shqipe dhe legjislacionit shqiptar në një nga gjuhët e Bashkimit Evropian” është ngritur dhe funksionon pranë Ministrisë së Integritit, Drejtoria e Përkthimit të Legjislacionit Evropian, e cila është struktura e vetme qendrore, që nëpërmjet kontraktimit të përkthyesve të licensuar kryen përkthimin e legjislacionit të Bashkimit Evropian në gjuhën shqipe dhe përkthimin e legjislacionit shqiptar në një nga gjuhët e Bashkimit Evropian si dhe çertifikon legjislacionin e përkthyer më parë ose atë që do të përkthehet nga Ministritë ose institucionet e tjera qendrore. Prioritetet e përkthimit do të caktohen në bashkëpunim me ministritë përkatëse në vijim të konsultimeve të rregullta me Komisionin Evropian.

#### *Aplikimi për Statusin e Vendit Kandidat në BE*

Muaji	Institucioni përgjegjës	Veprimi
Shkurt-Mars 2009	MPJ	Dorëzimi i letrës për anëtarësim
Prill 2009	MIE	Ngritja e një mekanizmi koordinues, ku të parashikohen qartë ndarjet vertikale dhe horizontale të punës, përgjegjësitë konkrete dhe axhenda normale e grupeve të punës
30 Prill 2009	MIE	Parashikimi në buxhet i shpenzimeve shtesë të lidhura me procesin e aplikimit
1-15 Maj 2009	MIE, ML	Konsultime me personat që do të angazhohen në Institucionet e Linjës për të evidentuar problemet potenciale në ndarjen e detyrave dhe trajnimi i tyre
Brenda 3 muajve nga data e marrjes së Pyetësorit	Të gjitha institucionet	Plotësimi i Pyetësorit*

\* Afatet e mesiperme mund të ndryshojnë në varesi të komunikimeve me KE



## 1A. Vlerësimi i zbatimit të "Planit Kombëtar për zbatimin e MSA-së"

Muaji	Data	Institucioni përgjegjës	Veprimi
Shkurt	1-7	MIE Ministritë e Linjës	MIE shpërndan udhëzimet dhe metodologjinë për rishikimin e PKZMSA-së. Ngrihen grupet ndërministrorë të punës që do të rishikojnë Planin Kombëtar. Vlerësohet zbatimi i detyrimeve të parashikuara për periudhën tetor 2008 - mars 2009 dhe analizohen shkaqet e mosrealizimit të angazhimeve të ndërmarra.
	15	Ministritë e Linjës	Rishikimi i afateve të realizimit të detyrimeve që rrjedhin nga dispozitat e Marrëveshjes së Stabilizim - Asociimit
		Ministritë e Linjës	Rishikimi i përgjegjësive institucionale të të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga MSA.
		Ministritë e Linjës	Rishikimi i prioritizimit të akteve legjislative të Bashkimit Evropian të cilat do të adoptohen në legjislacionin vendas.
	20	Ministritë e Linjës	Përshkrimi sektorial i ndihmës së huaj
	25	MIE Ministritë e Linjës	Rivlerësim i iniciativave ligjore që do të ndërmerren nga institucionet shtetërore në PKZMSA
25	MIE Ministritë e Linjës	Rivlerësim i aktiviteteve zbatuese që do të ndërmerren nga institucionet shtetërore në PKZMSA	
Mars	1	MIE Ministritë e Linjës	Rivlerësim dhe ripërcaktim i kapaciteteve administrative të nevojshme, sipas fushave sektoriale
	15	MIE MF	Rivlerësim dhe ripërcaktim i kostove financiare në përputhje me Planin Buxhetor Afatmesëm, 2009-2011
		MIE	Përditësim i sistemit të bazës së të dhënave me synim monitorimin elektronik të PKZMSA-së nga ministritë e linjës dhe institucionet e tjera qendrore
		MIE Institucionet shtetërore	Korrespondenca në rrugë zyrtare ndërmjet MIE dhe institucioneve shtetërore për transferimin e të dhënave në sistemin e të dhënave bazë të PKZMSA-së. Dërgimi i shkresave finale për të përmbyllur dokumentin final.
		MIE	Përpunimi i të dhënave dhe përgatitja e materialit final të PKZMSA 2009 - 2014 për dërgim në KM.
	31	MIE	Dërgimi i PKZMSA 2009- 2014 për miratim në KM
KM		Miratimi i VKM Nr 577 për "Disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr 463 datë 5.07.2006 të KM, për miratimin e Planit Kombëtar për Zbatimin e MSA-së"	

**1b. Monitorimi i Planit Kombëtar për Zbatimin e MSA-së**

Muaji	Data	Institucioni përgjegjës	Veprimi
Janar	4	Institucionet	Raporti mujor për monitorimin e zbatimit të MSA-së
Shkurt	4	Institucionet	Raporti mujor për monitorimin e zbatimit të MSA-së
Shkurt	20	MIE	Raporti dy mujor për Komisionin Evropian
Mars	4	Institucionet	Raporti mujor për monitorimin e zbatimit të MSA-së
Prill	4	Institucionet	Raporti mujor për monitorimin e zbatimit të MSA-së
Prill	20	MIE	Raporti dy mujor për Komisionin Evropian
Maj	4	Institucionet	Raporti mujor për monitorimin e zbatimit të MSA-së
Qershor	4	Institucionet	Raporti mujor për monitorimin e zbatimit të MSA-së
Qershor	20	MIE	Raporti dymujor për Komisionin Evropian
Korrik	4	Institucionet	Raporti mujor për monitorimin e zbatimit të MSA-së
	20	MIE	Raporti i progresit për Shqipërinë për procesin e stabilizim-asociimit-për periudhën qershor shtator 2009
Gusht	4	Institucionet	Raporti mujor për monitorimin e zbatimit të MSA-së
Shtator	20	MIE	Raporti i përditësuar i Progresit 2009
Tetor	4	Institucionet	Raporti mujor për monitorimin e zbatimit të MSA-së
Nëntor	4	Institucionet	Raporti mujor për monitorimin e zbatimit të MSA-së
Dhjetor	4	Institucionet	Raporti mujor për monitorimin e zbatimit të MSA-së

**2A. DSHIP dhe finalizimi i IPA-s 2009**

Muaji	Institucioni përgjegjës	Veprimi
Janar	MIE	Dorëzohen në Komisionin Evropian projekt-fishat për projektet përfundimtare që do të përfshihen në IPA 2009
Shkurt	MIE, Komisioni Evropian	Rishikimi i DSHIP (MIPD) 2007-2009
Shkurt-prill	Komisioni Evropian	Këshillim brenda Shërbimeve të Komisionit
Korrik	Komisioni Evropian	Miratimi i fishave të IPA-s për vitin 2009 nga Komiteti i IPA-s
Nëntor - Dhjetor	Këshilli i Ministrave	Miratimi i Marrëveshjes Financiare të IPA-s për vitin 2009

**2B. Programimi i IPA-s për vitin 2010**

Muaji	Institucioni përgjegjës	Veprimi
Qershor	MIE	Përgatitet Kalendari për Programimin e IPA-s
Korrik	MIE	Ngrihen grupet e brendshme të punës për identifikimin e prioriteteve sipas PKZMSA-së të rishikuar dhe hartohet lista e parë e projekteve
Korrik - Shtator	MIE, DEBASKON Ministritë e Linjës	Prioritetet e indentifikuara nga Ministria e Integritimit diskutohen me përfituesit
Shtator	MIE, DEBASKON Ministritë e Linjës	Përfundojnë konsultimet me Ministritë e Linjës
Tetor	KPS	Miratimi në KPS i projekt ideve të IPA 2010
Tetor	Këshilli i Ministrave / Komisioni Evropian	Negociohen projektet e miratuara
Dhjetor	Ministritë e Linjës	Finalizimi i projekt-fishave të IPA-s për vitin 2010

**2D. Decentralizimi**

Muaji	Institucioni përgjegjës	Veprimi
Janar-Shkurt	MF NJQFK	Plotësimi me staf i strukturës së re të NJQFK-së
Janar	MF NJQFK	Fillimi i programit të Asistencës Teknike të KE-së lidhur me NJQFK
Janar 2009-2011	MF NJQFK	Implementi i AT-ës, draftimi i manualeve të procedurave, trainimi i stafit, sigurimi i akreditimit të NJQFK-së nga KE

**3. Përkthimi i "Acquis Communautaire" në gjuhën shqipe**

Muaji	Institucioni përgjegjës	Veprimi
Dhjetor 2008- Janar 2009	MIE	Hartimi i akteve nënligjore për funksionimin e Njesisë dhe procesit të përkthimit të "acquis"
Janar 2009	MIE	Konsultimet me ministritë e linjës për caktimin e prioriteteve ne lidhje me aktet për t'u përkthyer
Janar-Mars	MIE	Zhvillimi i procedurave për përzgjedhjen e përkthyesve dhe krijimi i Komitetit të Posaçëm ad-hoc të rishikimit të përkthimit
Mars	MIE	Ngritja e kapaciteteve të përkthimit sipas kërkesave të <i>Acquis</i>
Mars-Dhjetor	MIE	Përkthimi "Acquis" sipas prioriteteve

## PROGRAMI BUXHETOR AFATMESEM [PBA]

### Proceset dhe produktet kryesore

1. *Vlerësimi dhe parashikimi makroekonomik*
2. *Aktualizimet ekonomike dhe financiare*
3. *Përgatitja e PBA-së për periudhën 2010-2012 dhe e Buxhetit të Shtetit 2010*
4. *Procedurat e reja të Menaxhimit të Investimeve Publike në zbatim*
5. *Integrimi i Menaxhimit të Investimeve Publike në PBA*

Shënime:

- Datat dhe veprimet që lidhen me PBA-në përmenden edhe në pjesë të tjera

### Vështrim i përgjithshëm

#### 1. *Vlerësimi dhe parashikimi makroekonomik*

Analiza dhe parashikimi makroekonomik për periudhën 2009-2012 përgatitet në fillim të vitit me qëllim që të ofrohet informacioni për përcaktimin e përparësive strategjike, shpenzimeve agregate, synimeve në lidhje me të ardhurat dhe defiçitin, si dhe tavanëve për përgatitjen e PBA-së në nivel ministrie. Parashikimi fillestar përgatitet gjatë muajit dhjetor dhe finalizohet në fillim të muajit janar. Vlerësimi dhe parashikimi përditësohen në dy momente kyç gjatë vitit: në muajin prill, përpara finalizimit të PBA-së dhe të tavanëve të PBA-së për shpenzimet (në këtë kohë mund të merren në shqyrtim edhe masat në lidhje me tatimin), dhe në muajin gusht, përpara se të dërgohet në Parlament projekt Buxheti i Shtetit. Miratimi i dytë i kuadrit makro të rishikuar gjatë vitit 2008, u bë në muajin gusht dhe i treti në muajin tetor.

#### 2. *Përditësimet Ekonomike dhe Financiare dhe Raportet*

Çdo tre muaj do të botohen përditësimet përsa i përket ecurisë ekonomike dhe financiare të vendit. Këto do të përgatiten në fund të çdo tremujori. Përveç kësaj, vlerësimi i fundvitit do të mbarojë përpara fundit të tremujorit të parë. Një raport vjetor i paraqitet Komisionit Evropian përpara fundit të muajit nëntor.

#### 3. *Përgatitja e PBA-së për periudhën 2010-2012 dhe e Buxhetit të Shtetit 2010*

PBA-ja e parë që përfshinte të gjitha ministritë u zbatua në vitin 2006 (PBA-ja/Buxheti për periudhën 2007-2009). PBA-ja u paraqit për informacion në Parlament bashkë me Buxhetin e Shtetit. Në vitin 2009, fazat kyçe të PBA-së që do të zhvillohen në njësitë e qeverisjes qendrore dhe fondet e tyre speciale janë si më poshtë:

- Miratimi nga KM i vlerësimit dhe parashikimit makroekonomik
- Caktimi i tavanëve për përgatitjen e PBA-së
- Dërgimi i Udhëzimit të Përgatitjes së buxhetit nga MF
- Përfundimi i Rishikimit të Politikës së Programit (RPP)
- Përfundimi i Planifikimit të Shpenzimeve dhe Investimeve të Programit (PShIP); dhe
- Paraqitja e kërkesave buxhetore nga njësitë e qeverisjes qendrore (Faza I)
- Shqyrtimi i kërkesave buxhetore nga MF, MIE dhe DEBASKON (Faza I)
- Zhvillimi i seancave dëgjimore me njësitë e qeverisjes qendrore, me pjesëmarrje edhe të MIE dhe DEBASKON (Faza I)
- Shqyrtimi në KPS i draftit të parë të PBA-së dhe miratimi i kuadrit makro të rishikuar

- Miratimi në KM i draftit të parë të PBA-së dhe miratimi i kuadrit makro të rishikuar
- Dërgimi i Udhëzimit Plotësues të përgatitjes së buxhetit
- Paraqitja e Kërkesave Buxhetore nga njësitë e qeverisjes qendrore (Faza II)
- Shqyrtimi i kërkesave buxhetore nga MF, MIE dhe DEBASKON (Faza II)
- Zhvillimi i seancave dëgjimore me njësitë e qeverisjes qendrore, me pjesëmarrje edhe të MIE dhe DEBASKON(Faza II)
- Miratohet në KM parashikimi i përditësuar makro
- Paraqitet në KPS projektbuxheti vjetor dhe drafti i rishikuar i PBA-së
- Miratimi në KM i projektbuxhetit vjetor dhe draftit të rishikuar të PBA-së
- Dorëzimi në Kuvend i projektligjit të buxhetit vjetor dhe dokumentit të rishikuar të PBA-së

Gjatë muajit qershor, KM do të shqyrtojë dhe miratojë draftin e parë të PBA-së dhe tavanet e PBA-së për shpenzimet. Gjatë muajit tetor do të shqyrtohet dhe miratohet drafti i dytë i PBA-së si dhe projektbuxheti vjetor.

Në të kaluarën, ka ekzistuar një lidhje e dobët mes PBA-së dhe Buxhetit. Kjo situatë u përmirësua në vitin 2007, ndonëse kufijtë e ngushtë kohorë çuan në njëfarë mospërputhje. Qëllimi në vitin 2009 është, që të realizohet një kalim pa probleme nga PBA-ja në buxhet. Në parim, të gjithë vendimet kryesore lidhur me shpenzimet duhet të kalojnë përmes procesit të miratimit të PBA-së dhe transformimi i PBA-së në kërkesa buxhetore duhet të jetë kryesisht një detyrë teknike.

Përsa i përket planifikimit të investimeve publike, ai do të vazhdojë në kuadër të procesit të PBA-së dhe të buxhetit. Për shembull, në tavanet për përgatitjen e PBA-së do të përfshihet një tavan për investimet publike për çdo institucion. Në kalendarin më poshtë janë paraqitur afatet kryesore përsa i përket PBA-së dhe buxhetit, ku do të përfshihet një dimension i planifikimit të investimeve publike.

## KALENDARI PËR PBA-NË DHE BUXHETIN PËR VITIN 2009

Muaji	Data	Institucioni përgjegjës	Veprimi
Dhjetor 2008		MF	Përgatit dhe paraqet në KPS Kalendarin e MSHP-së
Dhjetor 2008		KPS	Shqyrton dhe miraton Kalendarin e MSHP-së
Dhjetor 2008	28	MF	Përfundojnë konsultimet e brendshme mbi Raportin mbi Vlerësimet dhe Parashikimet Makroekonomike dhe Buxhetore (R.V.P.M.B)
Dhjetor 2008	30	MF	Paraqet në KPS Raportin mbi Vlerësimet dhe Parashikimet Makroekonomike dhe Buxhetore (R.V.P.M.B)
Dhjetor 2008	31	KM	Shqyrton dhe miraton Kalendarin e MSHP-së
Janar	6	KPS	Miraton Raportin mbi Vlerësimet dhe Parashikimet Makroekonomike dhe Buxhetore (R.V.P.M.B)
Janar	7	KM	Miraton R.V.P.M.B
Janar	14	KM	Shqyrton dhe miraton Programin Ekonomik Fiskal
Shkurt	2	MF	Paraqet në KPS tavanet e përgatitjes së PBA-së
Shkurt	6	KPS	Shqyrton dhe miraton tavanet e përgatitjes së PBA-së
Shkurt	11	KM	Miraton tavanet e përgatitjes së PBA-së
Shkurt	16	MF	Dërgon Udhëzimin e Përgatitjes së Buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore dhe fondet e tyre speciale.
Shkurt	23	KM	Paraqet për informacion R.V.P.M.B dhe tavanet në Kuvend
Shkurt - Prill	9 30	Njësitë e Qeverisjes Qendrore dhe Fondet Speciale të tyre	Përgatisin kërkesat e tyre buxhetore
Prill	20	MF	Dorëzon për miratim në KPS parashikimin e përditësuar makro
Prill	27	KPS	Miraton parashikimin e përditësuar makro
Prill	29	KM	Miraton parashikimin e përditësuar makro
Maj	1	Njësitë e Qeverisjes Qendrore dhe Fondet Speciale të tyre	Paraqesin në MF kërkesat e tyre buxhetore
Maj	4 - 16	MF, MIE dhe DEBASKON	Kryen analizat e kërkesave buxhetore
Maj	18 - 29	MF, MIE dhe DEBASKON	Organizon seancat dëgjimore me institucionet buxhetore
Qershor	1 - 10	MF	Përgatit dokumentin e PBA-së dhe tavanet e reja të shpenzimeve të PBA-së
Qershor	11	MF	Paraqet dokumentin e PBA-së dhe tavanet e reja të shpenzimeve të PBA-së për shqyrtim dhe miratim në KPS
Qershor	19	KPS	Miraton dokumentin e PBA-së dhe tavanet e reja të shpenzimeve të PBA -së
Muaji	Data	Institucioni përgjegjës	Veprimi

Qershor	30	KM	Shqyrton dhe miraton me vendim dokumentin e PBA-së dhe tavanet përfundimtare të PBA-së
Korrik	1 - 31	KM	I paraqet Kuvendit për informacion dokumentin e rishikuar të PBA-së
Korrik	10	MF	Dërgon Udhëzimin Plotësues të Përgatitjes së Buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore dhe fondet e tyre speciale.
Korrik - Gusht	13 30	Njësitë e Qeverisjes Qendrore dhe Fondet Speciale të tyre	Përgatisin kërkesat e rishikuara buxhetore
Gusht	17	MF	Dorëzon në KPS parashikimin e përditësuar makro
Gusht	21	KPS	Miraton parashikimin e përditësuar makro
Gusht	26	KM	Miraton parashikimin e përditësuar makro
Gusht	31	Njësitë e Qeverisjes Qendrore dhe Fondet Speciale të tyre	Paraqesin në MF kërkesat e rishikuara buxhetore
Shtator	1 - 11	MF, MIE dhe DEBASKON	Kryen analizat e kërkesave të rishikuara buxhetore
Shtator	14 - 30	MF, MIE dhe DEBASKON	Organizon seancat dëgjimore me institucionet buxhetore
Tetor	5	MF	Paraqet në KM parashikimin e përditësuar makro
Tetor	9	KPS	Miraton parashikimin e përditësuar makro
Tetor	14	KM	Miraton parashikimin e përditësuar makro
Shtator - Tetor	30 20	MF	Përgatit dokumentin e rishikuar të PBA-së dhe e paraqet për shqyrtim në KPS
Shtator - Tetor	30 20	MF	Përgatit projektbuxhetin vjetor dhe e paraqet për shqyrtim në KPS
Tetor	23	KPS	Miraton projektbuxhetin vjetor dhe dokumentin e rishikuar të PBA
Tetor	28	KM	Shqyrton dhe miraton me vendim projektbuxhetin Vjetor dhe dokumentin e rishikuar të PBA
Tetor	30	KM	I paraqet Kuvendit për informacion projektligjin e buxhetit vjetor dhe dokumentin e rishikuar të PBA-së

## 2. Përditësimet ekonomike dhe financiare dhe Raportet

Muaji	Data	Veprimi
Mars		Vlerësimi Makroekonomik dhe Financiar për vitin 2008
Prill		Përditësimi tremujor Ekonomik dhe Financiar për vitin 2009
Korrik		Përditësimi tremujor Ekonomik dhe Financiar për vitin 2009
Tetor		Përditësimi tremujor Ekonomik dhe Financiar për vitin 2009
Nëntor		Raporti Vjetor Makroekonomik për Komisionin Evropian

## NDIHMA E HUAJ

### Proceset dhe produktet kryesore

1. Monitorimi i Ndhmës së Huaj
2. Aktivitetet për Koordinimin e donatorëve
3. Monitorimi i zbatimit të Deklaratës së Parisit

### Vështrim i përgjithshëm

#### *1. Monitorimi i Ndhmës së Huaj*

Në prill 2008 u lançua Dokumenti për Orientimin e Ndhmës së Huaj, i cili përmbledh përparësitë afatmesme të Qeverisë për t'u siguruar që ndihma e huaj përforcon arritjen e qëllimeve të strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale. Në vitin 2009 do të bëhet monitorimi i ndihmës së huaj nëpërmjet përditësimit dhe analizimit të të dhënave mbi programet dhe projektet e donatorëve si dhe hartimit të Raportit të Progresit për Ndhmën e Huaj. Në 2009 do të rishikohen procedurat e menaxhimit të ndihmës së huaj, të cilat do t'i hapin rrugë dizenjimit dhe më pas lançimit të EAMIS (Sistemi i Menaxhimit të Informacionit për Ndhmën e Huaj). EAMIS do të mundësojë menaxhimin strategjik të ndihmës së huaj duke përfshirë përgatitjen e raporteve, duke përcaktuar prioritetet dhe mbështjetjen nga donatorët, monitorimin dhe vlerësimin e projekteve, vlerësimin e ndihmës së huaj në tërësi, etj.

#### *2. Aktivitetet për Koordinimin e donatorëve*

Koordinimi i donatorëve do të vazhdojë të bëhet nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme si Tryezat e Rrumbullakëta Qeveri-Donatorë, Grupet Sektoriale të Punës me donatorët, misione të ndryshme, negociata dypalëshe, dhe programe speciale. Gjithashtu do të punohet për organizimin e Konferencës Rajonale për Koordinimin e Donatorëve. Do të vazhdojë bashkëpunimi me Sekretariatit Teknik të Donatorëve dhe Grupin Mbështetës të SPI-së. Datat e tryezave të rrumbullakëta dhe konferencës rajonale që do të zhvillohen gjatë vitit janë përfshirë në kalendarin më poshtë. Në fillim të vitit 2009 do të hartohet kalendari i misioneve programuese/negociuese të donatorëve si edhe kalendari i takimeve të Grupeve Sektoriale të Punës me donatorët.

#### *3. Monitorimi i zbatimit të Deklaratës së Parisit*

Në zbatim të angazhimeve kundrejt Deklaratës së Parisit, në bashkëpunim me Sekretariatit Teknik të Donatorëve, do të hartohet Plani i Veprimit të Harmoniz, në të cilin do të përcaktohen veprimet për t'u ndjekur gjatë dy viteve në vijim, nga Qeveria dhe donatorët për të përmirësuar efektivitetin e ndihmës së huaj. Gjithashtu lançimi i Anketës 2010 do të bëhet në muajin nëntor 2009. DEBASKON dhe Ministria e Financave janë Koordinatorët Kombëtarë në menaxhimin e anketës, ndërsa Sekretariati Teknik i Donatorëve shërben si pikë kontakti.



**KALENDARI PËR ASISTENCËN E HUAJ PËR VITIN 2009**

**1. Monitorimi i Ndhmës së Huaj**

Muaji	Data	Veprimi
Janar		Përditësimi dhe analizimi i të dhënave mbi projektet e donatorëve
Janar-Prill		Rishikimi i procedurave të menaxhimit të ndihmës së huaj
Shkurt		Hartimi i Raportit të Progresit të Ndhmës së Huaj
		Miratimi në KPS i Raportit të Progresit të Ndhmës së Huaj dhe lançimi i tij
Mars		Miratimi i Procedurave të reja të menaxhimit të ndihmës së huaj
Mars-Maj		Konceptimi i Procedurave të EAMIS
Qershor		Përditësimi dhe analizimi i të dhënave mbi projektet e Donatorëve
Tetor - Dhjetor		Lançimi i EAMIS

**2. Aktivitete për koordinimin e donatorëve**

Muaji	Data	Veprimi
		Takimi i grupit mbështetës të SPI-së
Janar		Hartimi i kalendarit të misioneve programuese dhe marrëveshjeve të bashkëpunimit me donatorët
		Hartimi i kalendarit të takimeve të Grupeve Sektoriale të Punës
2-3 Prill		Konferenca Rajonale për Koordinimin e Donatorëve, Tiranë, organizuar nga EC DG-ENLARG dhe DEBASKON
Maj		Takimi i grupit mbështetës të SPI-së
		Tryeza e rrumbullakët Qeveri - Donatorë
Tetor		Takimi i grupit mbështetës të SPI-së
		Konferenca Rajonale për Koordinimin e Donatorëve, Bruksel
Nëntor		Tryeza e rrumbullakët Qeveri - Donatorë

**3. Monitorimi i Zbatimit të Deklaratës së Parisit**

Muaji	Data	Aktiviteti
Janar		Lançimi i procesit të hartimit të Planit të Veprimit për Harmonizimin
		Hartimi i Planit të Veprimit për Harmonizimin
Maj		Miratimi nga donatorët dhe Qeveria i PVH-së
		Miratimi në KPS i Planit të Veprimit për Harmonizimin
Nëntor		Përgatitja për Anketimin mbi Monitorimin e Deklaratës së Parisit për 2010

**BOTIME NË KUADËR TË SPI PËR VITIN 2009**

**1. Botime në kuadër të SPI-së**

Muaji	Institucioni përgjegjës	Botimi
Shkurt	DEBASKON	Kalendari i SPI-së
Mars	DEBASKON	Raporti i Progresit të Ndhmës së Huaj 2008
Prill-Maj	ML	PIM-et 2009 për 14 Ministritë e Linjës
Çdo muaj	DEBASKON dhe DTS	Botimi informativ i përmuajshëm i "Government-Donor Dialogue"
Qershor	DEBASKON	Raporti i Progresit të SKZHI-së për vitin 2008
Tetor	MF	Botimi i projektbuxhetit

**KALENDARI PARAPRAK I TAKIMEVE TË KPS PËR VITIN 2009**

Muaji	Data	Aktiviteti
Janar	6	Miratimi në KPS i kuadri makroekonomik 2010-2012
Shkurt	6	Shqyrtimi në KPS i Dokumentit mbi Politikat Prioritare që ndikojnë në caktimin e taveve Miratimi në KPS i taveve të ministrive për PBA 2010-2012
Mars	20	Miratimi i Raportit të Progresit i Ndhmës së Huaj dhe procedurat e reja të menaxhimit të ndihmës së huaj
Prill	27	Miratimi në KPS i kuadrit të përditësuar makroekonomik, 2010-2012
Qershor	19	Miratimi në KPS i dokumentit të PBA-së dhe taveve të reja të shpenzimeve të PBA -së
Gusht	21	Miratimi në KPS i kuadrit të përditësuar makro dhe diskutimi i çështjeve të buxhetit Paraqitja e projektbuxhetit të shtetit për miratim përfundimtar nga KM
Tetor	9 23	Miratimi në KPS i kuadrit të përditësuar makroekonomik Miratimi në KPS i projektbuxhetit vjetor dhe dokumentit të rishikuar të PBA Miratimi në KPS i projekt ideve të IPA 2010